



Breaking News: Vlorë/Ndezi zjarrin në oborrin e banesës së tij, arrestohet 60-vjeçari



24/09/2026

DVP Tiranë/Finalizohen 2 Operacione Për Ndalimin E Shtetasve Që Mbajnë Armë, Pa Leje

DVP Tiranë/Finalizohen në 24 orë, si rezultat i punës operative, 2 operacione për ndalimin e shtetasve që mbajnë armë, pa leje.

Sekuestrohen 3 armë, 17 kapsolla elektrike, municion luftarak, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe 1 peshorë elektronike.

Arrestohen 2 poseduesit e sendeve të kundërligjshme.

Si rezultat i shtimit të vigjilencës operacionale në të gjithë territorin e qarkut dhe intensifikimit të punës operative, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale që mund të kryhen nga shtetas që posedojnë ilegalisht, armë, u finalizuan në 24 orë, 2 operacione. Konkretisht:

-Forca e Posaçme “Shqiponja”, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, në kuadër të operacionit të koduar “Qëllimi”, arrestuan shtetasin A. Z., 36 vjeç (me precedent penal), pasi iu gjetën në banesë, 2 armë zjarri (pistoletë dhe automatike), municion luftarak, një shënjestër optike, 2 mjete prerëse dhe 1 peshorë elektronike;

-shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, në kuadër të operacionit të koduar “Kontrolli”, arrestuan shtetasin F. L., 28 vjeç, në banesën e të cilit, në fshatin Brret, u gjetën 1 armë gjahu, 84 fishekë dhe 17 kapsolla elektrike, që posedoheshin pa leje.

Vijojnë hetimet për të zbardhur dhe dokumentuar përfshirjen e 2 shtetasve të arrestuar, në veprimtari kriminale.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



DVP Tiranë/Finalizohen 2 operacione për ndalimin e shtetasve që

Policia e Shtetit



Watch on

◀ Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit

Vlorë/Ndezi zjarrin në oborrin e banesës së tij, arrestohet 60-vjeçari ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent